Klinika Universitare e Gastroenterohepatologjisë, Shkup

Hyrje: Agonistët e GLP-1 (GLP-1 RA) përmirësojnë ndjeshëm kontrollin metabolik dhe normalizojnë transaminazat te pacientët me diabet tip 2 dhe MASLD/MASH. Megjithatë, testet standarde të funksionit hepatik nuk reflektojnë dëmtimin real strukturor të parenkimës . Normalizimi i ALT/AST mund të maskojë fibrozën e avancuar ose cirrozën e heshtur, duke e bërë elastografinë një ekzaminim të domosdoshëm për vlerësimin e saktë strukturor të mëlçisë.

Përshkrimi i rastit: Në këtë punim paraqitet rasti i një pacienti 54-vjeçar me anamnezë të gjatë të diabetit melitus tip 2, hipertensionit arterial dhe steatozës hepatike kronike. Nën terapinë me Semaglutide (1 mg/javë), u evidentua përmirësim i theksuar metabolik (humbje peshe >13%, optimizim glikemik dhe normalizim i transaminazave). Ndonëse ky kuadër krijonte përshtypjen e një mëlçie klinikisht të qetë, ekzaminimi elastografik (SWE) zbuloi dëmtim të rëndë strukturor, në stadin e cirrozës hepatike (F4).

Diskutim: Ky rast vë në pah një paradoks gjithnjë e më të shpeshtë në hepatologjinë bashkëkohore: efikasiteti i lartë i GLP-1 RA në reduktimin e steatozës dhe normalizimin e enzimave hepatike shpesh maskon praninë e fibrozës së avancuar. Kjo mospërputhje mes parametrave laboratorikë optimalë dhe dëmtimit real strukturor e bën elastografinë të pazëvendësueshme për identifikimin në kohë të cirrozës së kompensuar dhe parandalimin e komplikimeve madhore.

Konkluzion: Normalizimi i transaminazave te pacientët me diabet tip 2 nën trajtim afatgjatë me GLP-1 RA nuk përjashton praninë e fibrozës së avancuar. Elastografia e mëlçisë duhet të jetë pjesë e pandashme e protokollit të rregullt të ndjekjes në sindromën metabolike, duke shmangur neglizhimin e një cirroze të kompensuar dhe duke mundësuar nisjen e hershme të masave parandaluese.

Fjalë kyçe: GLP-1 RA; MASLD/MASH; Sindromë metabolike; Elastografi hepatike (SWE).

TRAJTIMI I OBEZITETIT MORBID ME GASTREKTOMI SLEEVE LAPAROSKOPIKE: PËRVOJË PROSPEKTIVE NË NJË QENDËR TË VETME

G. Elezi[1], L. Sejfullahu-Elezi[1], M. Rustemi-Elezi[1], Z. Elezi[2], B. Elezi[2], E. Bekteshi[2]

[1] Spitali Klinik Universitar "8 Shtatori", Shkup, Maqedonia e Veriut
[2] Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut

Hyrje: Obeziteti morbid është një sëmundje kronike e shoqëruar me komplikacione të rëndësishme metabolike dhe kardiovaskulare. Gastrektomia sleeve laparoskopike (LSG) është një procedurë bariatrike e sigurt dhe efektive. Ky studim paraqet përvojën fillestare të institucionit tonë, duke vlerësuar realizueshmërinë, sigurinë dhe rezultatet e hershme klinike.

Objektivi: Të vlerësohet siguria, realizueshmëria dhe rezultatet klinike të hershme të gastrektomisë sleeve laparoskopike te pacientët me obezitet morbid, duke analizuar humbjen e peshës, komplikacionet postoperative dhe përmirësimin e komorbiditeteve metabolike të lidhura me obezitetin.

Materiali dhe metodat: Një studim prospektiv observacional përfshiu 30 pacientë me obezitet morbid, të cilët iu nënshtruan gastrektomisë sleeve laparoskopike gjatë periudhës 2019–2022. Të gjitha ndërhyrjet u kryen sipas një teknike të standardizuar laparoskopike, duke përdorur bougie 36-Fr dhe staplera Endo-GIA. U vlerësuan rezultatet operative, komplikacionet postoperative, indeksi i masës trupore (BMI), përqindja e humbjes së peshës së tepërt (%EWL), qëndrimi spitalor dhe komorbiditetet e lidhura me obezitetin.

Rezultatet: Tridhjetë pacientë (18 gra, 12 burra), me moshë mesatare 39.1 ± 10.2 vjet dhe BMI 46.8 ± 6.1 kg/m^2, iu nënshtruan gastrektomisë sleeve laparoskopike. Koha mesatare operative ishte 84 ± 18 minuta, me një konvertim në kirurgji të hapur. Nuk u shënuan mortalitet apo komplikacione madhore. Qëndrimi mesatar spitalor ishte 3.3 ± 0.8 ditë. Pas 12 muajsh, %EWL arriti 69.2 ± 10.8%. U vu re përmirësim i diabetit mellitus tip 2 në 80%, hipertensionit arterial në 85.7% dhe apnesë obstruktive të gjumit në 89.5% të pacientëve. Ndjekja e rregullt postoperative ndikoi pozitivisht në rezultatet e humbjes së peshës.

Përfundimi: Gjetjet tona tregojnë se gastrektomia sleeve laparoskopike siguron ulje të konsiderueshme të peshës dhe përmirësim të gjendjeve të lidhura me obezitetin, me rrezik të ulët perioperativ. Procedura ishte e sigurt dhe efektive në përvojën tonë. Nevojiten studime më të mëdha dhe ndjekje afatgjatë për konfirmimin e përfitimeve të qëndrueshme metabolike.

Përfundim i shkurtër: Gastrektomia sleeve laparoskopike është trajtim i sigurt dhe efektiv për obezitetin morbid, duke siguruar humbje të konsiderueshme në peshë dhe përmirësim të komorbiditeteve. Rekomandohen studime të mëtejshme për vlerësimin e rezultateve afatgjata.

TREATMENT OF MORBID OBESITY WITH LAPAROSCOPIC SLEEVE GASTRECTOMY: A PROSPECTIVE SINGLE-CENTER EXPERIENCE

G. Elezi[1], L. Sejfullahu-Elezi[1], M. Rustemi-Elezi[1], Z. Elezi[2], B. Elezi[2], E. Bekteshi[2]

[1] University Clinical Hospital "8 September", Skopje, North Macedonia
[2] Faculty of Medical Sciences, University of Tetova, North Macedonia

Introduction: Morbid obesity is a chronic disease associated with significant metabolic and cardiovascular morbidity. Laparoscopic sleeve gastrectomy (LSG) has emerged as a safe and effective bariatric procedure. This study presents our institution's initial experience, evaluating feasibility, safety, and early clinical outcomes.

Objective: To evaluate the safety, feasibility, and early clinical outcomes of laparoscopic sleeve gastrectomy in patients with morbid obesity, focusing on weight loss, postoperative complications, and improvement of obesity-related metabolic comorbidities.

Material and Methods: A prospective observational study included 30 consecutive patients with morbid obesity who underwent laparoscopic sleeve gastrectomy between 2019 and 2022. All procedures were performed using a standardized laparoscopic technique with a 36-Fr bougie and Endo-GIA staplers. Operative outcomes, postoperative complications, body mass index (BMI), percentage of excess weight loss (%EWL), hospital stay, and obesity-related comorbidities were prospectively evaluated.

Results: Thirty patients (18 women, 12 men), with a mean age of 39.1 ± 10.2 years and BMI of 46.8 ± 6.1 kg/m^2, underwent laparoscopic sleeve gastrectomy. The mean operative time was 84 ± 18 minutes, with one conversion to open surgery. No mortality or major complications occurred. The mean hospital stay was 3.3 ± 0.8 days. At 12 months, %EWL reached 69.2 ± 10.8%. Type 2 diabetes mellitus, arterial hypertension, and obstructive sleep apnea improved in 80%, 85.7%, and 89.5% of patients, respectively. Regular postoperative follow-up was associated with improved weight loss outcomes.

Conclusion: Our findings demonstrate that laparoscopic sleeve gastrectomy provides significant weight reduction and improvement of obesity-related conditions with low perioperative risk. The procedure was safe and effective in our experience. Larger studies with longer follow-up are required to confirm sustained benefits and assess long-term metabolic outcomes.

WHAT IS GLP-1 AND GIP THERAPY TEACHING US ABOUT DEPRESSION AND ANXIETY IN WOMEN WITH PMOS: CASE REPORT

Rr. Elezi, E. Tresi, H. Sejfuli

Clinical University Tetovo

The subjective and multifactorial nature of anxiety and depression makes their quantitative assessment challenging, particularly in patients with complex endocrine disorders such as polyendocrine menstrual ovarian syndrome (PMOS). However, with the introduction of glucagon-like peptide-1 (GLP-1) receptor agonists and dual glucose-dependent insulinotropic polypeptide (GIP)/GLP-1 receptor agonists, an increasing number of studies and clinical observations have reported significant improvements in symptoms of anxiety, depression, and overall psychological well-being among women with PMOS and those in the perimenopausal period. While improvements in body mass index (BMI) and body composition undoubtedly contribute to enhanced self-image and quality of life, many patients describe additional benefits that extend beyond weight reduction. One of the most frequently reported effects is the marked reduction in persistent thoughts about food, commonly referred to as "food noise," suggesting a potential influence of these therapies on reward pathways, emotional eating, and addictive behaviors. These observations also raise important questions regarding the complex interactions between metabolic dysfunction, hyperandrogenism, central neurotransmitter systems, particularly serotonin, and mental health. We present the case of a 47-year-old perimenopausal woman with established PMOS who was treated with combined GIP/GLP-1 receptor agonist therapy and experienced remarkable improvements in metabolic parameters, psychological well-being, and food-related intrusive thoughts. This case highlights the potential therapeutic role of incretin-based therapies beyond the management of obesity and infertility, emphasizing their possible benefits for mental health and addictive eating behaviors in women with PMOS.

Keywords: incretine therapy; perimenopause; obesity: PMOS; GLP-1: GIP

EFEKTET ANËSORE TË AGONISTËVE TË RECEPTORIT GLP-1

T. Shehu Kolnikaj[1,2]

[1] Endokrinologe, Spitali amerikan 3.

[2] Lektore , Universiteti i mjekësisë Tiranë.

Agonistët e receptorit të GLP-1 (GLP-1 RA) kanë transformuar trajtimin e diabetit mellitus tip 2 dhe obezitetit, duke ofruar përfitime të rëndësishme metabolike dhe kardiovaskulare. Me zgjerimin e përdorimit të tyre, njohja dhe menaxhimi i efekteve anësore po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme në praktikën klinike. Efektet gastrointestinale, veçanërisht nauzea, të vjellat, diarrea dhe konstipacioni, janë më të shpeshtat, zakonisht shfaqen gjatë titrimit dhe në shumicën e rasteve janë të përkohshme dhe të menaxhueshme. Titrimi gradual i dozës, modifikimet dietike dhe

hidratimi adekuat mund të përmirësojnë tolerancën ndaj trajtimit.

Shqetësime të tjera të sigurisë përfshijnë pankreatitin, sëmundjet biliare, dëmtimin akut renal, retinopatinë diabetike dhe humbjen e masës jo-dhjamore. Megjithatë, të dhënat aktuale nuk mbështesin një rritje të qartë të riskut për kancer pankreatik apo të tiroides, ndërsa monitorimi afatgjatë mbetet i rëndësishëm. Në përgjithësi, GLP-1 RA kanë një profil të favorshëm përfitim–risk. Përzgjedhja individuale e pacientit, titrimi i kujdesshëm dhe njohja e hershme e efekteve anësore janë thelbësore për përdorimin e sigurt dhe afatgjatë.

Fjalë kyçe: GLP-1 RA; semaglutide; tirzepatide; obezitet; diabet tip 2; efekte anësore; siguri.

PËRTEJ ANASTAMOZAVE: KOMPLESKITETI MULTIDISIPLINAR PAS NJË TRANSPLANTI TË SUSKSESSHËM TË ZEMRËS: RAPORT RASTI

K. Xhelili, A. Selmani, E. Rushiti

IPSH Klinika Univerzitare për Kardiologji dhe Kirurgji Kardiovaskulare, Qendra Kombëtare Për Sëmundje Kardiovaskulare, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Hyrje: Transplantimi i zemrës përfaqëson ndërhyrjen më komplekse në kardiokirurgji, duke ofruar mbijetesë dhe përmirësim të cilësisë së jetës për pacientët me dobësim terminal të zemrës (1). Nga vlerësimi i donatorit dhe harvestimi i organit, deri te përgatitja e recipientit, implantimi, reperfuzioni dhe menaxhimi postoperativ, çdo fazë kërkon koordinim ndërmjet të gjithë anëtarëve të ekipit të transplantit (2; 3). Ne prezantojmë një rast që thekson hapat kirurgjikale, bashkëpunimin multidisiplinar dhe strategjitë perioperative të përfshira në realizimin e suksesshëm të transplantimit të zemrës.

Prezantimi i rastit: Pacienti është një mashkull 52-vjeçar me dobësim të zemrës (LVEF 37%) dhe simptoma të klasës III sipas NYHA. Pesë vite përpara, për shkak të dobësimit progresiv kardiak, pavarësisht terapisë optimale medikamentoze, ai u vendos në listën kombëtare të pritjes për transplant të zemrës. Tre vite përpara, për shkak të episodeve të përsëritura të stuhive të takikardisë ventrikulare iu implantua ICD, megjithatë ngarkesa aritmike mbeti e konsiderueshme. Kur një donator zemre u paraqit, u krye procesi i përzgjedhjes donator–recipient dhe pacienti u identifikua si recipienti optimal. Transplantimi ortotopik i zemrës u realizua me sukses, pa komplikacione intraoperative. Ecuria postoperative ishte e zgjatur, por në fund pacienti u rikuperua mirë, me funksion të qëndrueshëm të graftit. Ndjekja e rregullt post-transplant është ende në vazhdim.

Përfundim: Transplantimi i zemrës është më shumë se një operacion, është një proces kirurgjikal i orkestruar me kujdes, në të cilin çdo fazë ndikon në rezultatin përfundimtar. Zotërimi i teknikave të harvestimit të organit, ruajtjes së tij, implantimit dhe menaxhimit perioperativ është thelbësor për suksesin e transplantimit (2). Forcimi i strategjive për rritjen e dhurimit të organeve dhe bashkëpunimi

multidisiplinar mbeten faktorë themelorë për të siguruar që më shumë pacientë të mund të përfitojnë nga kjo procedurë shpëtuese për jetën (3; 4).

THE ROLE OF LIVER ELASTOGRAPHY IN THE CONTEMPORARY ASSESSMENT AND MANAGEMENT OF MASLD: FROM RISK STRATIFICATION TO CLINICAL PRACTICE

A. Hasani Jusufi

University Clinic of Gastroenterohepatology, Skopje

Introduction: MASLD represents the leading cause of chronic liver disease globally, where fibrosis directly determines prognosis and mortality. Due to the invasiveness and limitations of liver biopsy, ultrasound elastography is the primary choice for assessing risk non-invasively.

Aim: To summarize and analyze the latest clinical data on the role of ultrasound elastography methods (VCTE, pSWE, and 2D-SWE) in the early diagnosis of advanced fibrosis, disease course monitoring, and therapeutic decision-making in patients with MASLD.

Discussion: The sequential combination of the serum FIB-4 test with ultrasound elastography (pSWE/2D-SWE) clarifies indeterminate cases and avoids unnecessary liver biopsies. The diagnostic accuracy of liver stiffness measurement (LSM) depends on strict adherence to technical quality criteria (IQR/median ≤ 30%, quiet breath-hold, adequate measurement depth), as well as on the recognition of confounding factors (acute necroinflammation with elevated transaminases, cholestasis, vascular congestion, and postprandial status), which can lead to false overestimation of stiffness. In addition to accurate fibrosis staging, LSM carries high prognostic value in predicting clinically significant portal hypertension (CSPH according to the Baveno consensus) and in stratifying the risk of clinical decompensation in patients with advanced MASLD.

Conclusion: Liver elastography represents an essential and indispensable tool in modern MASLD management. Proper implementation of technical protocols and recognition of clinical limitations enable the early identification of high-risk patients, guiding metabolic and hepatological interventions in a timely manner.

Keywords: MASLD, liver fibrosis, ultrasound elastography, pSWE, 2D-SWE, liver stiffness measurement (LSM).

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI RESEKSIONIN ENDOSKOPIK TË TUMOREVE TË TRAKTIT GASTROINTESTINA (GIT)

U. Isahi

Spitali Klinik ACIBADEM SISTINA Shkup

Malinjitetet gastrointestinale (GI) përbëjnë më shumë se një të katërtën e të gjitha diagnozave të reja të kancerit në mbarë botën dhe paraqesin një barrë të rëndësishme për shëndetin publik. Me përmirësimin e teknologjive endoskopike përgjatë viteve, është mundësuar një zbulim shumë më i mirë i polipeve. Për shkak se malinjitetet e traktit GI shpesh janë asimptomatik (pa shenja klinike), këto lezione zbulohen kryesisht rastësisht në faza të ndryshme nga endoskopistët. Vlerësimi dhe klasifikimi i kujdesshëm i morfologjisë së polipeve është parësor për përzgjedhjen e metodës më të përshtatshme të rezeksionit endoskopik ose kirurgjikal.

Teknikat e rezeksionit endoskopik (RE) – si polipektomia, rezeksioni endoskopik i mukozës (REM) dhe diseksioni endoskopik i submukozës (DES) – janë gjerësisht të pranuara si trajtime minimale invazive për tumoret gastrointestinale. Pasi REM-ja ka kufizime në madhësinë e lezionit që mund të hiqet dhe shpesh kryhet në mënyrë të fragmentuar (pjesë-pjesë), bëhet e pamundur vlerësimi i saktë i shkallës së avancimit të kancerit. Kjo mund të çojë në mbetjen e pjesshme të tumorit ose në rishfaqjen (recidivimin) e tij në të ardhmen. DES-ja është një teknikë inovative që i tejkalon këto vështirësi.

Metodat e RE-së konsiderohen të përshtatshme për tumoret me potencial shumë të ulët të metastazimit në nyjet limfatike, duke mundësuar një rezeksion *"en-bloc"* (të plotë, në një pjesë të vetme). Me përhapjen e hovshme dhe të gjerë të DES-së, sfidat e trajtimit u zgjidhën gradualisht përmes zhvillimit të pajisjeve dhe teknologjive të reja. Si rrjedhojë, shkalla e rezeksionit kurativ (shërues) u rrit, ndërsa shkalla e komplikimeve pësoi rënie të ndjeshme.

Sot, teknikat e RE-së janë shndërruar në nje trajtimi standard për kancerin në faza të hershme dhe për lezionet prekanceroze, ndërsa indikacionet terapeutike po zgjerohen dita-ditës. Këto indikacione përcaktohen nga udhëzues (guidelines) specifikë për secilin organ, si ezofagu, stomaku dhe kolorektumi.

Në një shoqëri si e jona, e cila po pëson një plakje graduale, është mjaft e rëndësishme të shqyrtohen mundësi trajtimi më pak invazive në vend të atyre kirurgjikale. Për më tepër, përparimet e fundit në teknologjinë endoskopike po bëjnë të mundur heqjen e tumoreve submukozale, të cilat më parë kërkonin ndërhyrje të hapur kirurgjikale. Në këtë rishqyrtim, kemi përmbledhur indikacionet dhe udhërrëfyesit e fundit mbi standardet që lidhen me RE për çdo lokalizim në traktin gastrointestinal (GI), si dhe perspektivat e ardhshme.

OVERVIEW OF ENDOSCOPIC RESECTION OF GIT TUMORS

U. Isahi

Clinical Hospital ACIBADEM SITINA Skopje

Gastrointestinal (GI) malignancies account for more than a quarter of all new cancer diagnoses worldwide and represent a significant public health burden. Over the years, improvements in endoscopic technologies have enabled much better detection of polyps. Because GI tract malignancies are often asymptomatic (presenting no clinical signs), these lesions are mostly detected incidentally at various stages by endoscopists. Careful evaluation and classification of polyp morphology is paramount for selecting the most appropriate method of endoscopic or surgical resection.

Endoscopic resection (ER) techniques—such as polypectomy, endoscopic mucosal resection (EMR), and endoscopic submucosal dissection (ESD)—are widely accepted as minimally invasive treatments for gastrointestinal tumors. Because EMR has limitations regarding the size of the lesion that can be removed and is often performed in a piecemeal (fragmented) manner, it becomes impossible to accurately evaluate the stage of cancer progression. This can lead to leaving a portion of the tumor behind or its future recurrence. ESD is an innovative technique that overcomes these difficulties.

ER methods are considered suitable for tumors with a very low potential for lymph node metastasis, enabling an "en-bloc" resection (complete removal in a single piece). With the rapid and widespread adoption of ESD, treatment challenges were gradually resolved through the development of new devices and technologies. Consequently, the curative resection rate increased, while the complication rate decreased significantly.

Today, ER techniques have become a standard treatment for early-stage cancer and precancerous lesions, and therapeutic indications are expanding by the day. These indications are determined by specific guidelines for each organ, such as the esophagus, stomach, and colorectum.

In a gradually aging society like ours, it is highly important to consider less invasive treatment options as alternatives to surgical procedures. Furthermore, recent advancements in endoscopic technology have enabled the removal of submucosal tumors that previously required open surgery. In this review, we summarize the indications and latest guideline standards for endoscopic resection (ER) across each localization in the gastrointestinal (GI) tract, alongside future perspectives.

PËRTEJ INDEKSIT APNE–HIPOPNE: HIPOKSEMIA DHE ARKITEKTURA E GJUMIT NË APNENË OBSTRUKTIVE TË GJUMIT

R. Mustafa, I. Ismaili, Z. Shaini, I. Angelovska, S. Momcilovic

Klinika Univerzitare e Pulmo-alergologjise –Shkup

Apneja obstruktive e gjumit (AOGJ) është një nga çrregullimet më të shpeshta të frymëmarrjes gjatë gjumit dhe përbën një problem të rëndësishëm shëndetësor për

shkak të lidhjes së saj me komplikime kardiovaskulare, metabolike, neurokognitive dhe uljen e cilësisë së jetës. Tradicionalisht, diagnoza dhe klasifikimi i ashpërsisë së AOGJ-së bazohen kryesisht në indeksin apne–hipopne (AHI), i cili paraqet numrin mesatar të apneve dhe hipopneve për orë gjumi. Megjithatë, AHI nuk pasqyron plotësisht heterogjenitetin fiziopatologjik dhe rëndësinë klinike të sëmundjes.

Vlerësimi bashkëkohor i AOGJ-së kërkon interpretim më të gjerë të parametrave polisomnografikë. Veçanërisht të rëndësishëm janë shkalla dhe kohëzgjatja e hipoksemisë nokturne, indeksi i desaturimit të oksigjenit, saturimi mesatar dhe minimal i oksigjenit, si dhe koha e kaluar me saturim nën 90%. Këta parametra mund të japin informacion shtesë mbi ngarkesën hipoksike të pacientit, e cila nuk shprehet domosdoshmërisht vetëm nga vlera e AHI-së.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është arkitektura e gjumit. Fragmentimi i gjumit, zgjimet e shpeshta, ndryshimet në efikasitetin e gjumit dhe çrregullimet e fazës REM mund të ndikojnë në simptomatologjinë dhe pasojat klinike të AOGJ-së. Në veçanti, ngjarjet respiratore gjatë gjumit REM mund të shoqërohen me desaturime më të theksuara për shkak të ndryshimeve fiziologjike karakteristike të kësaj faze.

Prandaj, interpretimi i polisomnografisë nuk duhet të kufizohet vetëm në AHI. Integrimi i AHI-së me parametrat e oksigjenimit, ngarkesën hipoksike dhe arkitekturën e gjumit mundëson një vlerësim më gjithëpërfshirës të ashpërsisë së AOGJ-së dhe mund të kontribuojë në një qasje më të personalizuar diagnostike dhe terapeutike.

Fjalë kyçe: apneja obstruktive e gjumit; polisomnografia; indeksi apne–hipopne; hipoksemia; arkitektura e gjumit.

MENAXHIMI I PNEUMONISË SË RËNDË TË FITUAR NË KOMUNITET (SCAP)

I. Ismaili, Z. Shaini, R. Mustafa

Klinika Univerzitare e Pulmologjisë dhe Alergologjisë- Shkup

Hyrje: Pneumonia është një infeksion akut parenkimal me forma tipike (akute, konsolidim lobar) dhe atipike (intersticiale, patogjenë intracelularë/viruse). Forma e saj kritike (sCAP) mbart rrezik të lartë për jetën dhe kërkon mbështetje ventilatore, ku triazhimi me pikëzime prognostike (PSI, CURB-65) dhe biomarkerë (CRP, PCT) është vendimtar.

Qëllimi: Vlerësimi i profilit klinik, mikrobiologjik, biomarkerëve dhe faktorëve prognostikë te pacientët me sCAP.

Materiali dhe metodat: Studim retrospektiv i 265 pacientëve me CAP gjatë vitit 2025, prej të cilëve 35 plotësuan kriteret sCAP. U vlerësuan demografia, komorbiditetet, imazheria, mikrobiologjia, CRP, PCT, pikëzimet PSI/CURB-65, mbështetja respiratore (NIMV/IMV) dhe mortaliteti.

Rezultatet: sCAP përbënte 13,2% të rasteve (60,0% meshkuj, mosha 60–80 vjeç). Mbizotëruan hipertensioni (60,0%), diabeti (40,0%) dhe efuzioni pleural (40,0%). Patogjenët kryesorë ishin *S. aureus* (8,6%) dhe SARS-CoV-2 (8,6%). PSI (mediana 121)

parashikoi më mirë se CURB-65 nevojën për IMV. Markerët pësuan ulje sinjifikante: CRP nga 79 në 7,7 mg/L dhe PCT nga 2,13 në 0,35 ng/mL. NIMV u aplikua në 11,4% të rasteve, IMV në 8,6%, ndërsa mortaliteti ishte 2,9%.

Konkluzion: sCAP prek kryesisht moshën e tretë me polimorbiditet. PSI shfaq saktësi më të lartë se CURB-65 për parashikimin e IMV, ndërsa rënia e CRP dhe PCT konfirmon ecurinë pozitive terapeutike.

Fjalë kyçe: Pneumonia e rëndë e fituar në komunitet; prokalcitoninë; CURB-65; NIMV; IMV

DIAGNOSTIKIMI DHE TRAJTIMI BASHKËKOHOR I SARKOIDOZËS

Z. Shaini, I. Ismaili, R. Mustafa

Klinika Univerzitare e Pulmologjisë dhe Alergologjisë- Shkup

Hyrje: Sarkoidoza është sëmundje inflamatore multisistemike me etiologji të panjohur, e karakterizuar nga formimi i granulomave jokazeoze, me përfshirje më të shpeshtë të mushkërive dhe nyjeve limfatike intratorakale. Diagnostikimi kërkon vlerësim klinik, imazherik dhe histopatologjik, si dhe përjashtimin e sëmundjeve të tjera granulomatoze.

Qëllimi: Të paraqiten qasjet bashkëkohore diagnostike dhe terapeutike te sarkoidoza, me theks të veçantë në metodat bronkoskopike, rolin e EBUS-it dhe përvojën klinike në trajtimin e pacientëve.

Materiali dhe metodat: U analizua përvoja e Klinikës së Pulmologjisë dhe Alergologjisë në Shkup gjatë dy viteve të fundit, duke përfshirë 31 pacientë të diagnostikuar me sarkoidozë. U shqyrtuan karakteristikat klinike, stadet e sëmundjes, metodat diagnostike dhe qasjet terapeutike.

Rezultatet: Nga 31 pacientët e regjistruar, 5 (16%) u shtruan në spital, ndërsa 21 (67%) paraqiteshin në stadet II–III të sëmundjes. EBUS-i paraqitet si metodë me rëndësi të veçantë në diagnostikimin e limfadenopatisë hilare dhe mediastinale, duke mundësuar marrjen e mostrave me invazivitet më të ulët krahasuar me metodat kirurgjikale. Të gjithë pacientët simptomatikë u trajtuan me kortikosteroide, me kohëzgjatje mesatare prej gjashtë muajsh, ndërsa 5 pacientë (16%) morën metotreksat.

Përfundimi: Diagnostikimi i sarkoidozës kërkon qasje të integruar dhe përjashtim të kujdesshëm të diagnozave diferenciale. EBUS-i përfaqëson një metodë të rëndësishme diagnostike, ndërsa trajtimi duhet të individualizohet sipas simptomave, rrezikut të dëmtimit të organeve dhe ecurisë së sëmundjes.

Fjalë kyçe: Sarkoidoza, diagnostikimi, EBUS, kortikosteroidet

WHEN RISK FACTORS CONVERGE: EXTENSIVE DEEP VEIN THROMBOSIS IN A PATIENT WITH METASTATIC BREAST CANCER

A. Bakiu[2], I. Kuzmanoski[1], A. Fazliu[1], A. Bajrami[2], E. Vrajnko[1], M. Bosevski[1]

[1] University Clinic for Cardiology and Cardiovascular Surgery, National Center for Cardiovascular Diseases, Skopje, North Macedonia
[2] General Hospital Kumanovo, Kumanovo, North Macedonia

Introduction: Cancer-associated venous thromboembolism is a serious complication, particularly in metastatic disease. Tumor-induced hypercoagulability, anticancer therapy, and immobilization contribute to increased thrombotic risk.

Objective: To present a case of extensive acute deep vein thrombosis (DVT) in a patient with metastatic breast cancer and recent post-traumatic immobilization.

Materials and Methods: A female patient presented with a three-day history of left leg pain and swelling. Diagnosed with invasive ductal carcinoma of the right breast in 2023, she underwent radical mastectomy and chemotherapy, subsequently developing pulmonary metastases. Her ongoing treatment included palbociclib, fulvestrant, and goserelin. Six weeks before admission, she sustained a fracture of the left fourth toe, requiring four weeks of immobilization. Evaluation included laboratory testing, venous Doppler ultrasonography, and transthoracic echocardiography.

Results: Doppler ultrasonography confirmed acute thrombosis involving the left femoral, popliteal, peroneal, and tibial veins. Laboratory findings revealed elevated D-dimer (8,544 ng/mL) and CRP (55.1 mg/L). Echocardiography showed preserved left ventricular systolic function (LVEF 59%) and normal right ventricular dimensions without signs of right ventricular overload. Anticoagulation was initiated with enoxaparin and subsequently transitioned to rivaroxaban. Follow-up Doppler demonstrated early popliteal vein recanalization. The patient was discharged hemodynamically stable, with recommendations for repeat Doppler ultrasonography and regular follow-up visits.

Conclusion: This case highlights the multifactorial nature of cancer-associated DVT and emphasizes early diagnosis, individualized anticoagulation, and regular follow-up evaluations.

Keywords: Deep vein thrombosis, breast cancer, immobilization, anticoagulation.

ACUTE BILIARY PANCREATITIS SECONDARY TO CHOLEDOCHOLITHIASIS IN A PATIENT FOLLOWING CHOLECYSTECTOMY

A. Bajrami[2], A. Bakiu[2], J. Todorovska[1], A. Imeri[3], Lj. Deriban[1], Xh. Adem[1,4]

[1] University Clinic of Gastroenterology, Skopje, North Macedonia
[2] General Hospital Kumanovo, North Macedonia
[3] General Hospital "Ferid Murati" Gostivar, North Macedonia
[4] Faculty of Medicine, Ss. Cyril and Methodius University, Skopje, North Macedonia

Introduction: Acute biliary pancreatitis (ABP), also known as gallstone pancreatitis, is an acute and potentially life-threatening inflammatory condition of the exocrine pancreas. It occurs when a migrating gallstone or biliary sludge obstructs the common bile duct or pancreatic duct, disrupting the normal outflow of digestive secretions. ABP is the leading cause of acute pancreatitis worldwide and accounts for approximately 50% of hospital admissions for acute pancreatitis in Western countries. Although prior cholecystectomy significantly reduces the risk of biliary complications, retained or newly formed common bile duct stones remain an important and frequently overlooked clinical challenge.

Aim: To present a case of acute biliary pancreatitis caused by choledocholithiasis in a patient with a history of cholecystectomy and to highlight the roles of multimodal diagnostic imaging (EUS and MRCP) and therapeutic ERCP.

Case Description: A 46-year-old man presented to the emergency department with severe epigastric pain of 3–4 days' duration. His medical history was notable for cholecystectomy and a family history of pancreatitis. He was a smoker and reported no alcohol consumption. The diagnostic workup included laboratory testing, abdominal ultrasonography, computed tomography (CT), endoscopic ultrasonography (EUS), and magnetic resonance cholangiopancreatography (MRCP). Laboratory tests revealed markedly elevated pancreatic enzymes (amylase, 955 U/L; lipase, 1,302 U/L), together with a cholestatic and inflammatory biochemical profile (GGT, 771 U/L; ALT, 273 U/L; AST, 137 U/L; total bilirubin, 25.3 µmol/L). Abdominal ultrasonography and CT demonstrated post-cholecystectomy status, a hyperechoic pancreas, and dilation of the common bile duct to 9 mm, without clear CT evidence of focal obstruction. EUS and MRCP identified an oval stone measuring 7.8–10 mm in the distal, prepapillary segment of the common bile duct. Endoscopic retrograde cholangiopancreatography (ERCP) was performed, with adequate papillotomy and successful balloon extraction of the stone. Complete ductal clearance was achieved without post-procedural complications.

Discussion and Conclusion: Previous cholecystectomy does not exclude the possibility of biliary pancreatitis. EUS and MRCP are accurate modalities for detecting choledocholithiasis when conventional imaging is inconclusive. Timely therapeutic ERCP can rapidly relieve the obstruction and result in an excellent clinical outcome.

Keywords: Acute biliary pancreatitis, choledocholithiasis, cholecystectomy, EUS, MRCP, ERCP

MINOCA TEK PACIENT ME NEOPLAZI MIELOPROLIFERATIVE – PREZENTIM RASTI

A. Idrizi

Hyrje: Infarktin akut të miokardit më së shpeshti e njohim dhe definojm me sëmundjen aterosklerotike të arterieve koronare dhe praninë e stenozave të signifikante të arterieve koronare. Megjithatë, te një numër i caktuar pacientësh, infarkti i miokardit mund të shfaqet edhe në mungesë të sëmundjes obstruktive të arterieve koronare. Kjo gjendje njihet si infarkti i miokardit me arterie koronare jo-obstruktive (MINOCA – *Myocardial Infarction with Non-Obstructive Coronary Arteries*).

MINOCA përfaqëson një entitet klinik heterogjen me mekanizma të ndryshëm të mundshëm, ndër të cilët janë : spazma koronare, disfunksioni mikrovaskular koronar, tromboza ose embolia koronare, si dhe shkaqe të tjera të dëmtimit të miokardit. Gjendjet hiperkoaguluese, përfshirë neoplazitë mieloproliferative, veçanërisht policitemia vera, përfaqësojnë një faktor rreziku të rëndësishëm, por potencialisht të nënvlerësuar, për ngjarje trombotike arteriale dhe infarkt të miokardit.

Prezentim rasti: Një pacient 33-vjeçar, me neoplazi mieloproliferative të diagnostikuar më parë në vitin 2018 (bazuar në vlera persistente të rritura të hemoglobinës, hematokritit dhe numrit të trombociteve, si dhe në praninë e mutacionit JAK2,) u shtrua në klinikën tonë për shkak të dhimbjes së fortë në gjoks.

Elektrokardiogrami (EKG) në momentin e pranimit tregoi elevacion të ST segmentit në derivacionet prekordiale, ndërsa analizat laboratorike treguan vlerë të konsiderueshme të rritur të troponinës T (hs-cTnT), prej 1080 ng/L (vlera referente <14 ng/L).

Bazuar në pamjen klinike, ndryshimet elektrokardiografike dhe vlerat dukshëm të rritura të biomarkerëve kardiakë, fillimisht u vendos diagnoza e infarktit akut të miokardit me elevim të ST segmentit (STEMI).

Pacienti iu nënshtrua koronarografisë urgjente, gjatë së cilës u vizualizuan arterie koronare qe rezultuan normale dhe pa stenoza signifikante (Figura 2). Në përputhje me pamjen klinike dhe gjetjet e koronarografisë, u vendos diagnoza pune e MINOCA-s.

Analizat laboratorike shtesë te pacientit treguan eritrocitozë, leukocitozë dhe trombocitozë, në përputhje me neoplazinë mieloproliferative bazë.

Për vlerësim të mëtejshëm etiologjik u krye rezonanca magnetike kardiake (CMR). Ekzaminimi konfirmoi dëmtim akut ishemik të miokardit në regjionet përkatëse, me praninë e obstruksionit mikrovaskular (MVO) (Figura 3).

Diskutim: Neoplazitë mieloproliferative shoqërohen me rrezik të shtuar për ngjarje trombotike, të cilat variojnë nga çrregullime të lehta të mikrocirkulacionit deri te trombozat serioze arteriale dhe venoze.

MINOCA përfaqëson një sfidë diagnostike që kërkon një qasje multimodale dhe vlerësim të kujdesshëm të mekanizmave të mundshëm patofiziologjikë. Te pacientët me neoplazi mieloproliferative, rreziku i shtuar trombotik duhet të merret parasysh edhe në mungesë të aterosklerozës koronare të rëndësishme.

Kur koronarografia nuk arrin të identifikojë shkakun themelor të infarktit të miokardit, metodat joinvazive të imazherisë — veçanërisht rezonanca magnetike kardiake (CMR) — kanë rol kyç në vendosjen e diagnozës.

Fjalë kyçe: MINOCA, sindroma mieloproliferative, MRI

PERSISTENCA E PES PLANUS NGA MOSHA 6 DERI NË 9 VJEÇ: TË DHËNA NGA KONTROLLET SISTEMATIKE PEDIATRIKE ME PLANTOGRAM DIGJITAL

A. Bektashi Qerimi[1], G. Murati[2], S. Bislimi[1]

[1] IPSH Shtëpia e shëndëtit Shkup-Poliklinika Çento

[2] Spitali I Përgjithshëm-reparti i pediatrisë Kumanovë

Hyrje: Pes planus, ose shputa e rrafshët, është një gjetje e shpeshtë gjatë zhvillimit të sistemit muskuloskeletal te fëmijët. Ndjekja e ndryshimeve të harkut plantar gjatë rritjes është e rëndësishme për të kuptuar evolucionin e kësaj gjendjeje.

Qëllimi: Të vlerësohet prania e Pes planus te fëmijët në moshën 6 vjeç dhe persistenca e saj në moshën 9 vjeç, me analizë sipas gjinisë.

Metodat: U realizua një studim longitudinal gjatë kontrolleve sistematike shëndetësore të fëmijëve. Në moshën 6 vjeç u ekzaminuan 527 fëmijë, prej të cilëve 253 meshkuj dhe 274 femra. Vlerësimi i shputave u krye me plantogram digjital. Pes planus u evidentua në 89 fëmijë, përkatësisht 58 meshkuj dhe 31 femra. Pas tre vitesh, në moshën 9 vjeç, u krye kontrolli i dytë sistematik shëndetësor. Numri total i fëmijëve të ekzaminuar ishte 451, për shkak të mungesave dhe largimit të disa nxënësve nga shkollat.

Rezultatet: Në moshën 6 vjeç, Pes planus u evidentua në 89/527 fëmijë (16.9%). Në moshën 9 vjeç, 54 fëmijë të grupit të identifikuar në moshën 6 vjeç vazhdonin të paraqisnin Pes planus, përkatësisht 36 meshkuj dhe 18 femra. Kjo përfaqëson 60.7% të 89 fëmijëve fillestarë me Pes planus. Persistenca ishte 36/58 (62.1%) te meshkujt dhe 18/31 (58.1%) te femrat.

Përfundimi: Ndjekja longitudinale me plantogram digjital gjatë kontrolleve sistematike pediatrike mundëson monitorimin e evolucionit të Pes planus gjatë rritjes. Në këtë grup fëmijësh u evidentua persistencë e Pes planus në një pjesë të konsiderueshme të rasteve pas tre vitesh, me përqindje të ngjashme ndërmjet meshkujve dhe femrave.

Fjalë kyçe: Pes planus; fëmijë; plantogram digjital; zhvillimi muskuloskeletal; pediatri.

RECURRENT ERYSIPELAS – A CASE REPORT

A. Jankoski[1], H. Džaferi[1], E. Bubaćoska-Jankoska[2], N. Džaferi[3], M. Bajrami[4], G. Elezi[4]

[1] PHI "Emergenca" – Studeničani
[2] HI "St. Ilija" – Skopje
[3] University Clinic for Orthopedic Diseases – Skopje
[4] PHI General Hospital – Kumanovo

Introduction: Erysipelas is an acute, non-purulent bacterial infection of the superficial dermis, characterized by marked inflammation of the lymphatic vessels. Clinically, it presents as a well-demarcated, raised, warm, erythematous edematous lesion accompanied by prominent systemic symptoms.

Established systemic risk factors for erysipelas include obesity, diabetes mellitus, chronic alcohol use, and immunosuppression. Local factors that compromise skin barrier integrity and serve as portals of entry for pathogens are strongly associated with increased susceptibility. The most significant among these include cutaneous fungal infections, chronic edema or lymphedema, prior trauma, surgical interventions, venous insufficiency, and chronic dermatoses affecting the ipsilateral extremity.

Recurrent erysipelas predominantly affects the lower extremities and typically recurs at the site of the initial episode. Reported recurrence rates vary across studies, with approximately 10–30% of patients experiencing relapse within weeks to years following the primary episode. Recurrence is thought to result from repeated bacterial invasion through a compromised cutaneous barrier.

Accurate identification and management of predisposing factors are essential for reducing disease-related morbidity, optimizing therapeutic outcomes, and implementing effective preventive strategies, particularly in high-risk populations.

Case Report: We report the case of a 60-year-old female patient who experienced her first episode of erysipelas involving the left lower leg in 2015. Over a 10-year period (2015–2025), the patient developed a total of 12 recurrent episodes. Of these, 10 occurred on the ipsilateral (left) side, while only 2 episodes involved the contralateral (right) lower leg.

The patient's medical history revealed multiple predisposing factors, including bilateral lower limb lymphedema, obesity, superficial thrombophlebitis of the left lower leg, and persistent interdigital fungal infection of both feet, which proved difficult to manage.

Prodromal systemic symptoms—such as chills, fever, and malaise—consistently preceded each episode by several days. These were followed by localized erythema, swelling, and pain in the affected limb.

Laboratory investigations demonstrated leukocytosis, neutrophilia, elevated erythrocyte sedimentation rate (ESR), and increased C-reactive protein (CRP) levels, consistent with acute inflammation.

The patient received systemic antibiotic therapy, including third-generation cephalosporins and clindamycin, along with adjunctive topical treatment (boric acid solution, corticosteroid ointment, and antifungal agents).

Prophylactic therapy with benzathine phenoxymethylpenicillin (1,500,000 IU once daily) was initiated and maintained for six months, during which no recurrence was observed. However, following a three-month discontinuation of prophylaxis, the patient experienced another episode of erysipelas.

Subsequently, long-term prophylactic antibiotic therapy was reintroduced and continued for one year, during which no further recurrences have been documented.

Conclusion: Erysipelas should be regarded as a recurrent and potentially chronic condition. Preventive strategies are essential in all patients with acute erysipelas to reduce the risk of recurrence.

In addition to long-term antibiotic prophylaxis, the cornerstone of prevention lies in the identification and elimination of modifiable risk factors. These include minimizing mechanical trauma, treating potential portals of entry (e.g., chronic ulcers, tinea pedis, onychomycosis, pruritic dermatitis, and chronic venous insufficiency), the use of compression therapy, weight reduction, and strict glycemic control in diabetic patients.

Recurrent erysipelas is associated with significant morbidity. Therefore, early recognition of risk factors and timely implementation of both therapeutic and preventive measures are crucial in reducing recurrence rates, preventing complications, and improving patient outcomes.

Keywords: erysipelas; recurrent erysipelas; risk factors; prophylaxis

TRAJTIMI I FRAKTURËS SË PJESËS SË MESME TË KLAVIKULËS TE PACIENTËT E RRITUR – NDJEKJE 3 VJEÇARE

A. Belcishta Shaqiri[1], S. Ferati Belcishta[2], M. Vrtanoska[2], S. Rustemi Selami[3], E. Kuculovska Cvetkovska[3], M. Samardziski[4], I. Shabani[4], I. Merdzanoski[4]

1. Institucioni Publik Shëndetësor (IPSH) Qendra Shëndetësore Shkup – Poliklinika "Çair", Departamenti i Ortopedisë
2. IPSH Mediars
3. IPSH Spitali i Përgjithshëm i Qytetit (GOB) "8 Shtatori", Mjekësia Fizikale dhe Rehabilitimi
4. IPSH Klinika Universitare për Sëmundje Ortopedike – TOARILUC, Qendra Klinike "Nënë Tereza"

Hyrje: Frakturat e klavikulës janë lëndime të shpeshta, që përbëjnë afërsisht 2,6–4% të të gjitha frakturave te të rriturit. Për dekada me radhë ato janë trajtuar në mënyrë konservative, ndonëse shkalla e mos-konsolidimit (mos-bashkimit të kockës) pas trajtimit konservativ duket të jetë më e lartë. Megjithatë, tashmë disponohen më shumë të dhëna në lidhje me trajtimin operativ.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të paraqesë konceptet dhe menaxhimin aktual lidhur me trajtimin e frakturave të klavikulës, si dhe rezultatet e ndjekjes së pacientëve pas trajtimit.

Materiali: Në studimin tonë janë përdorur të dhëna nga dy pacientë meshkuj, të

moshës 40 dhe 65 vjeç, me frakturë të pjesës së mesme të klavikulës, të ndjekur përgjatë një periudhe trevjeçare.

Metoda: Diagnoza fillestare është vendosur përmes anamnezës dhe ekzaminimit klinik, dhe është konfirmuar me radiografi (Rtg). Janë përdorur si trajtimi konservativ ashtu edhe ai operativ. Në bashkëpunim me fiziatrit, pacientët janë përfshirë në terapi ditore, me kontrolle radiografike në javët e 2-të, 4-t, 6-të dhe 8-të. Terapia tjetër plotësuese është përshtatur sipas nevojave të pacientëve.

Rezultatet: Në të dyja rastet kemi arritur sukses si me trajtimin konservativ ashtu edhe me atë operativ, duke rikthyer forcën muskulore dhe funksionalitetin brenda 2 muajve.

Përfundimi: Në përgjithësi, frakturat pa zhvendosje trajtohen në mënyrë konservative. Trajtimi operativ duhet të diskutohet me pacientët që kanë fraktura të klavikulës me zhvendosje, veçanërisht te pacientët e rinj dhe aktivë.

TREATMENT FOR MIDDLE PART CLAVICULAR FRACTURE IN GROWN UP PATIENTS- 3 YEARS FOLLOW UP

A. Belcishta Shaqiri[1], S. Ferati Belcishta[2], M. Vrtanoska[2] S. Rustemi Selami[3], E. Kuculovska Cvetkovska[3], M. Samardziski[4], I. Shabani[4], I. Merdzanoski[4]

1. PHI Health Center Skopje - Polyclinic Chair, Orthopedics Department
2. PHI Mediars
3.PHI GOB 8 Septemvri, Physical and Rehabilitation Medicine
4. PHI University Clinic for Orthopedic Diseases - TOARILUC, CC "Mother Teresa"

Introduction: Clavicular fractures are common injuries, accounting for approximately 2.6 – 4% of all adult fractures, and for decades have been treated conservatively, where non-union rates afer conservative appear higher. Even so more evidence regarding operative treatment has become available. Aim: The aim of this study is to present the current concepts and management regarding clavicle fracture treatment and their foĺlow up results. Material: In our study data are obtained from two male patients 40 years and 65 years old with clavicular fracture in middle part at three year timeline. **Method:** The work diagnosis is set through anamnesis and clinical exam, confirmed with an X-ray. Treatment option used are conservative and operative. In collaboration with physiatrists patients are included in daily therapy, with x-ray control in 2,4,6,8 week. Other therapy corresponds patient needs. Results: In our two cases we have success both in conservative and operative treatment , with gain muscles strength and performances within 2 months. **Conclusion:** In general, non-displaced fractures are treated conservatively. Operative treatment has to be discussed with patients with displaced clavicle fractures, especially in the young and active patient.

CYCLOTHERAPY AS A THERAPEUTIC APPROACH IN A PATIENT WITH NEOVASCULAR GLAUCOMA CAUSED BY CENTRAL RETINAL VEIN OCCLUSION

A. Rizvanolli[1], M. Rushiti[2], B. Emini[3], G. Jakupi Isa[4]

[1] General Hospital, Ferizaj, R. Kosovo
[2] Clinical Hospital, Tetovo, R. North Macedonia
[3] Institute of Occupational Medicine, Skopje, R. North Macedonia
[4] General Hospital, Struga, R. North Macedonia

Objective: According to the European Glaucoma Society, glaucoma is a progressive optic neuropathy. Neovascular glaucoma is a severe and aggressive form of secondary glaucoma characterized by rapid progression and frequent complications. The most common causes are diabetic retinopathy and central retinal vein occlusion. These patients most commonly present with signs of ocular hypertension: increased intraocular pressure, corneal edema, a fixed pupil, and iris rubeosis. Treatment of neovascular glaucoma depends on the patient's visual function and symptoms; if the visual prognosis is poor, surgical treatments are preferred. In addition to conservative treatment, cyclodestructive procedures such as cyclocryotherapy and cyclophotocoagulation are suggested to relieve and manage symptoms.

Study objective: The aim was to evaluate the effect of cyclotherapy on reducing intraocular pressure and relieving symptoms in a 43-year-old female patient with neovascular glaucoma and a previous history of central retinal vein occlusion, previously treated with anti-VEGF in the left eye. Transscleral cyclotherapy was performed at a temperature of -55°C, 2 mm posterior to the limbus for 15 seconds at each point over 50% of the circumference of the ciliary body, avoiding the 3 and 9 o'clock positions because of possible complications.

Methods: A clinical case from my practice is reported. All information was obtained from the patient's official medical history during diagnosis and treatment.

Results: Intraocular pressure before the intervention was >41.4 mmHg, whereas 24 hours after the intervention it decreased to 26.6 mmHg. Symptoms such as pain and headache were significantly relieved.

Conclusion: Intraocular pressure decreased effectively following cyclotherapy, and symptoms were substantially relieved in this case of neovascular glaucoma. This method may be a reasonable palliative approach for patients with poor visual prognosis when surgical options are limited.

OKLUZIONI I PERFUZIONIT PERZISTENT TË LUMENIT FALS ME TEKNIKËN CANDY-PLUG PAS NJË RIPARIMI HIBRID MULTISTADIAL TË AORTËS SI PASOJË E DISEKSIONIT TË AORTËS STANFORD TIP A: RAPORT RASTI

A. Selmani, K. Xhelili, E. Rushiti

IPSH Klinika Univerzitare për Kardiologji dhe Kirurgji Kardiovaskulare, Qendra Kombëtare Për Sëmundje Kardiovaskulare, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Results: Operative time, complication rates, hospital length of stay, Body Mass Index (BMI), % of Excess Weight Loss (EWL) and appetite were evaluated. There were 3 females and 5 males, aged (mean+/-SD) 35.5+/-10.5 yrs and preoperative BMI 47.8+/-7.5 kg/m2. Three of them had Diabetes mellitus type 2 (8 mmol/L +/- 3 mmol/L), Sleep apnea all of the patients, Hypertension four of them (140/90 mmHg +/- 20/15 mmHg). The operative time was 110.7+/-30 min. There was one conversion to open surgery. All patients, except one, were discharged on the forth postoperative day after an upper GI series and the initiation of a clear liquid diet. At the follow-up (3.0 +/-1.0 months post operatively), the % EWL was 30.5+/-10.5. Six patients who received regular postoperative dietician counselling at follow-up did better than the others who did not (% EWL 35.4+/-5.8 vs 25.2+/-4.1, respectively). All patients reported significant loss of appetite.The three patients that were with diabetes mellitus had significant improvement. Sleep apnea normalized at all of the patients that underwent LSG. Hypertension improved at all of them.

Conclusions: Although the number of patients is relatively small, the data of this study indicate that laparoscopic sleeve gastrectomy is effective in weight reduction, normalization of diabetes mellitus type 2, loss of sleep apnea and normalization of blood hypertension. A higher number of patients and longer follow-up period will be necessary to evaluate long-term efficacy.

CLINICAL ASSESSMENT AND MEDICAL STRATEGIES IN THE TREATMENT OF PERIARTHRITIS HUMEROSCAPULARIS

G. Elezi[1], D. Georgieva[2], R. Dzoleva Tolevska[2], N. Xhaferi[2], A. Tasevski[1], M. Ademoski[3]

[1] PHI General Hospital of Kumanovo, North Macedonia
[2] University Clinic for Orthopedic Diseases, Skopje, North Macedonia
[3] PHI General Hospital of Kichevo, North Macedonia

Introduction: Periarthritis Humeroscapularis (PHS), widely known as frozen shoulder or adhesive capsulitis, is a pathological condition characterized by progressive pain and marked restriction of active and passive mobility of the glenohumeral joint. PHS affects approximately 2% to 5% of the general population, with a higher incidence among people aged 40–60 years and patients with endocrine disorders such as diabetes mellitus.

Objective: This paper aims to analyze clinical assessment methods and examine the effectiveness of various medical and rehabilitative therapeutic strategies for managing PHS. The paper also plans to analyze patients diagnosed with this condition at the General Hospital of Kumanovo during the period from January 2024 to September 2026.

Methods: A review of the medical scientific literature was conducted using the

PubMed, ScienceDirect, and Cochrane Library databases for the period 2015–2024. Controlled clinical studies, clinical guidelines, and systematic reviews addressing clinical diagnosis, pharmacological therapy, intra-articular injections, and physiotherapy for PHS were selected. In addition, a retrospective analysis of the medical records of patients diagnosed at the General Hospital of Kumanovo from January 2024 through September 2026 will be conducted.

Results: Clinical assessment is based primarily on a detailed history and physical examination, with loss of external rotation being an important finding. First-line therapy may include nonsteroidal anti-inflammatory drugs (NSAIDs) and activity modification. Ultrasound-guided intra-articular corticosteroid injections have shown efficacy in reducing pain in the short term, particularly during the inflammatory phase. Combining injections with tailored kinesiotherapy may improve range of motion (ROM) and function. The results of the local analysis will be completed after patient data have been collected and processed.

Conclusions: An early, integrated medical and rehabilitative approach may help manage PHS. Clinical diagnosis and selection of treatment according to the stage of the disease aim to reduce symptoms and functional limitations. Conclusions regarding patients treated in Kumanovo will be drawn only after the clinical data for the specified period have been analyzed.

Keywords: Periarthritis Humeroscapularis, frozen shoulder, adhesive capsulitis, clinical assessment, intra-articular injections, rehabilitation.

NGA TOLERANCA NË ANAFILAKSI: REAKSION I PAPRITUR NDAJ CEFALOSPORINAVE TE NJË FËMIJË 17 MUAJSH

G. Murati, B. Ramizi, A. Bektashi

Reparti i Pediatrisë – Spitali i Përgjithshëm i Kumanovës

Hyrje: Cefalosporinat janë ndër antibiotikët më të përdorur në pediatri dhe përgjithësisht kanë profil të mirë sigurie. Megjithatë, ato mund të shkaktojnë reaksione të rënda të hipersensitivitetit të tipit të menjëhershëm, përfshirë edhe anafilaksinë, madje edhe te pacientët që më parë i kanë toleruar pa reaksione të padëshiruara.

Paraqitja e rastit: Paraqesim rastin e një fëmije 17 muajsh, me histori të infeksioneve të shpeshta respiratore me komponent obstruktive, i cili më parë ishte trajtuar disa herë me cefalosporina të gjeneratës së tretë, përfshirë ceftriaksonin, pa shfaqur reaksione të padëshiruara.

Gjatë administrimit intravenoz të ceftriaksonit, pacienti zhvilloi në mënyrë akute dispne, edemë të gjuhës dhe manifestime kutane në formë te urtikes dhe eritemës, me pasqyrë klinike në favor të anafilaksisë. Administrimi i barit u ndërpre menjëherë dhe u fillua trajtimi urgjent me adrenalinë intramuskulare si terapi e linjës së parë, së bashku me kortikosteroid dhe antihistaminik. Pas trajtimit u arrit stabilizim i shpejtë i gjendjes klinike. Terapia antibiotike u ndryshua dhe nuk pati komplikime të

mëtejshme. Anamneza familjare për alergji ndaj antibiotikëve ishte negative.

Diskutimi: Prezantimi klinik përputhet me një reaksion të tipit të menjëhershëm, me shumë gjasë të ndërmjetësuar nga IgE. Sensibilizimi ndaj barit mund të zhvillohet pas ekspozimeve të përsëritura, edhe në prani të tolerancës së mëparshme të mirë. Ky fenomen përbën një sfidë të rëndësishme klinike, veçanërisht në popullatën pediatrike, ku cefalosporinat përdoren shpesh.

Përfundimi: Anafilaksia e shkaktuar nga cefalosporinat është e rrallë, por potencialisht kërcënuese për jetën. Njohja e hershme e simptomave, ndërprerja e menjëhershme e barit dhe administrimi në kohë i adrenalinës janë thelbësore për një rezultat të favorshëm. Pas një reaksioni të tillë, është i domosdoshëm dokumentimi i duhur i dyshimit për alergji dhe vlerësimi i mëtejshëm alergologjik për përcaktimin e alternativave të sigurta dhe vlerësimin e rrezikut gjatë përdorimit eventual të antibiotikëve të tjerë β-laktamikë.

Fjalë kyçe: Anafilaksi; cefalosporina; ceftriakson; antibiotikë β-laktamikë; reaksion i ndërmjetësuar nga IgE.

RECURRENT ATYPICAL NEUROLEPTIC MALIGNANT SYNDROME ASSOCIATED WITH RISPERIDONE AND LOW-DOSE QUETIAPINE IN A YOUNG MAN WITH AUTISM AND SEVERE INTELLECTUAL DISABILITY: A CASE REPORT

H. Asipi, F. Bajrami, G. Manov, B. Selmani, V. Simonovska-Kirova

Department of Neurology, General Hospital Kumanovo, Kumanovo, North Macedonia

Background: Neuroleptic malignant syndrome (NMS) is a rare but potentially life-threatening adverse reaction associated with dopamine receptor antagonists. It may also occur with second-generation antipsychotics and may present atypically.

Case presentation: A 20-year-old man weighing 70 kg with autism spectrum disorder and severe intellectual disability experienced two clinically suspected episodes of atypical NMS. During the first episode, while taking risperidone 1 mg irregularly, he developed fever up to 38.5°C, profuse sweating, generalized muscle spasms/cramps, restlessness and agitation. Rigidity could not be reliably assessed. CK was 1736 U/L and decreased after risperidone withdrawal to 562 U/L after 5 days and 162 U/L after 11 days. Approximately one year later, quetiapine was increased to 75 mg/day. Within several days a similar syndrome developed, with Tmax 38.5°C and CK 1912 U/L. Quetiapine was discontinued and supportive treatment plus bromocriptine 2.5 mg three times daily was given. CK decreased to 131 U/L after 5 days with marked clinical improvement.

Conclusion: The recurrent temporal association with two different second-generation antipsychotics, CK elevation and improvement after drug withdrawal supports clinically suspected recurrent atypical NMS. The case highlights diagnostic difficulty in severe neurodevelopmental disorders and the need for caution with

future dopamine-blocking therapy.

Keywords: neuroleptic malignant syndrome; recurrent NMS; risperidone; quetiapine; autism; intellectual disability; creatine kinase; bromocriptine.

MENAXHIMI I DHIMBJES SË NYJEVE

I. Besimi[1,2], R. Zejneli[1,2], N. Rufati[1,2], N. Rustemi[1,2], B. Ismaili[1,2]

[1] Spitali Klinik Tetovë – Reparti i Kirurgjisë
[2] Fakulteti i shkencave mjeksore, Universiteti i Tetovës

Dhimbja është një mekanizëm kompleks neurofiziologjik dhe një nga përgjigjet më të rëndësishme mbrojtëse të organizmit ndaj dëmtimit të indeve. Në lëndimet e nyjeve, ajo nuk përfaqëson vetëm një simptomë klinike, por shërben si sinjal paralajmërues që kufizon lëvizjen dhe ngarkesën e strukturës së dëmtuar, duke reduktuar rrezikun e përkeqësimit të dëmtimit dhe duke krijuar kushte për procesin e rikuperimit. Megjithatë, dhimbja e pakontrolluar ose e zgjatur mund të humbasë funksionin e saj mbrojtës dhe të ndikojë negativisht në mobilitetin, rehabilitimin, gjumin, gjendjen emocionale dhe cilësinë e jetës së pacientit.

Nga aspekti patofiziologjik, dëmtimi i strukturave artikulare dhe periartikulare aktivizon një përgjigje inflamatore lokale, gjatë së cilës çlirohen mediatorë si prostaglandinat, bradikinina, histamina, citokinat proinflamatore dhe substanca P. Këta mediatorë aktivizojnë dhe sensibilizojnë nociceptorët periferikë, duke ulur pragun e tyre të aktivizimit dhe duke shkaktuar hiperalgjezi në zonën e dëmtuar. Impulset nociceptive transmetohen përmes fibrave aferente Aδ dhe C drejt palcës kurrizore dhe më pas në strukturat supraspinale, ku realizohet perceptimi dhe modulimi i dhimbjes. Në rastet kur stimulimi nociceptiv vazhdon për një periudhë të gjatë, mund të zhvillohet sensibilizimi qendror, duke kontribuar në persistencën e dhimbjes edhe përtej fazës fillestare të dëmtimit.

Menaxhimi adekuat i dhimbjes te lëndimet e nyjeve duhet të ruajë ekuilibrin ndërmjet rolit të saj mbrojtës dhe nevojës për reduktimin e vuajtjes së pacientit. Qasja bashkëkohore përfshin vlerësimin sistematik të intensitetit, karakterit dhe ndikimit funksional të dhimbjes, si dhe aplikimin e ndërhyrjeve farmakologjike dhe jofarmakologjike sipas gjendjes klinike. Analgjezikët dhe barnat antiinflamatore mund të përdoren kur janë të indikuara, ndërsa masat fizike, mbrojtja relative e nyjës, pozicionimi, aplikimi i të ftohtit në fazën akute kur është i përshtatshëm, rehabilitimi progresiv dhe edukimi i pacientit kontribuojnë në kontrollin e simptomave dhe rikthimin gradual të funksionit.

Komforti i pacientit duhet të konsiderohet pjesë integrale e menaxhimit të dhimbjes. Ai nuk nënkupton eliminimin absolut të çdo ndjesie dhimbjeje, por arritjen e një niveli të tolerueshëm që mundëson pushim adekuat, gjumë, mobilizim të sigurt dhe pjesëmarrje aktive në rehabilitim, pa maskuar shenjat e një dëmtimi që kërkon vlerësim të mëtejshëm. Një qasje individuale, multidisiplinare dhe e orientuar drejt pacientit mundëson kontroll më efektiv të dhimbjes, përmirësim të funksionit artikular dhe reduktim të rrezikut për zhvillimin e dhimbjes kronike.

Fjalë kyçe: dhimbja, lëndimet e nyjeve, nocicepcioni, inflamacioni, sensibilizimi periferik, sensibilizimi qendror, analgjezia, komforti i pacientit, rehabilitimi.

TRIAZHA KIRURGJIKALE NË URGJENCË RËNDËSIA E PRIORITIZIMIT TË HERSHËM NË MENAXHIMIN E PACIENTIT KIRURGJIK AKUT

I. Besimi[1,2], A. Rufati[1,2], J. Jakupi[1,2], R. Amiti[1,2], N. Imeri[1,2], A. Seferi[1,2]

Hyrje: Triazha kirurgjikale përfaqëson një proces dinamik të vlerësimit dhe prioritizimit të pacientëve me patologji akute kirurgjikale, me qëllim identifikimin e hershëm të gjendjeve që kërcënojnë jetën ose funksionin e organeve. Në kushtet e urgjencës, ku vendimmarrja duhet të realizohet brenda një intervali të kufizuar kohor, një sistem efikas triazhi mund të ndikojë drejtpërdrejt në kohën deri në trajtimin definitiv dhe në rezultatet klinike.

Qëllimi: Të vlerësohet rëndësia e triazhës së strukturuar kirurgjikale në identifikimin e pacientëve me rrezik të lartë, reduktimin e vonesave diagnostiko-terapeutike dhe optimizimin e menaxhimit të urgjencave kirurgjikale.

Materiali dhe metodat: U realizua një rishikim narrativ i parimeve bashkëkohore të triazhës dhe menaxhimit të pacientit kirurgjikal akut, me fokus në vlerësimin primar sistematik, statusin hemodinamik, shenjat e hipoperfuzionit, abdomenin akut, hemorragjinë, sepsën me burim kirurgjikal, traumën madhore dhe urgjencat vaskulare. U analizua gjithashtu rëndësia e rivlerësimit serial dhe e koordinimit multidisiplinar në procesin e vendimmarrjes.

Rezultatet dhe diskutimi: Vlerësimi i strukturuar mundëson njohjen e hershme të pacientëve me instabilitet hemodinamik, hemorragji aktive, peritonit, perforim të organit kavitar, ishemi akute, obstruksion të komplikuar, sepsë kirurgjikale dhe trauma të rënda. Në këto situata, diagnostikimi dhe reanimimi duhet të zhvillohen paralelisht me konsultën kirurgjikale dhe përgatitjen për trajtimin definitiv. Rivlerësimi i vazhdueshëm është esencial, pasi deteriorimi klinik mund të kërkojë rikategorizim të menjëhershëm të prioritetit. Protokollet e standardizuara dhe komunikimi ndërmjet urgjencës, kirurgjisë, anesteziologjisë dhe radiologjisë reduktojnë rrezikun e nën-triazhimit dhe vonesave të evitueshme.

Përfundim: Triazha kirurgjikale nuk duhet të konsiderohet vetëm si proces kategorizimi, por si komponent integral i vendimmarrjes klinike në urgjencë. Prioritizimi korrekt, rivlerësimi dinamik dhe aktivizimi në kohë i ekipit kirurgjikal mund të përshpejtojnë trajtimin definitiv dhe të kontribuojnë në përmirësimin e rezultateve klinike. Për specializantin e Kirurgjisë, aftësia për të identifikuar pacientin kohë-kritik dhe për të përcaktuar urgjencën e ndërhyrjes përbën një kompetencë themelore profesionale.

Fjalë kyçe: triazhë kirurgjikale; urgjencë kirurgjikale; pacient kritik; prioritizim; abdomen akut; traumë; kirurgji emergjente.

ADDRESSING SURGICAL CHALLENGES IN TOTAL HIP ARTHROPLASTY FOR COMPLEXES COXARTHROSIS

I. Shabani

Klinika univerzitare nene Tereza -Shkup . Klinika e Ortopedis

Introduction: Complex coxarthrosis presents significant challenges in total hip arthroplasty (THA)due to altered hip anatomy,bone loss,deformity,reduced bone quality,and associated soft –tissue abnormalities.These factors may complicate surgical exposure,implant postioning,restoration of hip biomechanics,and postoperative recovery.

Aim: The aim of this study was to evaluate the main surgical challenges encountered during total hip arthroplasty in patients with complex coxarthrosis and to assess the strategies used to achieve stable fixation, restore hip biomechanics, and minimize complications.

Methods: Patients undergoing primary or revision THA for complex coxarthrosis were evaluated with regard to preoperative planning, intraoperative findings ,surgical approach, implant selection,management of bone defects and deformities and postoperative outcomes.Particular attention was given to limb-length restoration,acetabular and femoral component positioning,intraoperative complications,and early functional recovery.

Results: Successful management of complex coxarthrosis requiredindividualized preoperative planning and careful assessement of anatomical abnormalities.The principal intraoperative challenges included difficult exposure acetabular bone deficiency,femoral deformity,restoration of the hip center of rotation and achieving appropriate implant stability.The use of individualized implant selection,meticulous bone preparation, and when necessary supplementary fixation techniques facilitated reconstruction and improved restoration of hip biomechanics.Early postoperative assessment demonstrated improvement in pain and functional status while complications werw primarily related to the complexity of the underlying anatomy.

Conclusion: Total hip arthroplasty in complex coxarthrosis requires detailed preoparative evaluation , careful intraoperative technique, and individualized reconstructive strategies.

Recognition of anatomical challenges and appropriate management of bone defects and deformities are essential for restoring hip stability and biomechanics and for achieving favorable clinical outcomes.

MENAXHIMI I ANAFILAKSISË NË PRAKTIKËN STOMATOLOGJIKE: NGA NJOHJA E SIMPTOMAVE DERI TE ADMINISTRIMI I ADRENALINËS

[1]I. Lenjani, [1]B. Maloku, [1]F. Lenjani

[1]Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – Poliklinika Stomatologjike

[3]Alma Mater Europaea – College of Medical Sciences "REZONANCA", Kosovë

Hyrje. Anafilaksia është një reaksion i rrallë, por potencialisht kërcënues për jetën, i mbindjeshmërisë sistemike, i cili mund të shfaqet gjatë trajtimit stomatologjik. Njohja e shpejtë e manifestimeve klinike dhe ndërhyrja e menjëhershme janë thelbësore për parandalimin e përkeqësimit respirator dhe kardiovaskular. Shkaktarët potencialë në praktikën stomatologjike përfshijnë antibiotikët, klorheksidinën, lateksin, anestetikët lokalë, analgjezikët dhe substanca të tjera të përdorura gjatë procedurave dentare.

Qëllimi. Qëllimi i këtij rishikimi ishte të përmbledhë njohjen dhe menaxhimin e menjëhershëm të anafilaksisë në praktikën stomatologjike, me theks të veçantë në vlerësimin e hershëm klinik, administrimin e shpejtë intramuskular të adrenalinës, përgatitjen për emergjenca dhe parandalimin e pasojave të padëshiruara.

Metodologjia. U krye një rishikim narrativ i literaturës shkencore relevante dhe rekomandimeve klinike bashkëkohore lidhur me anafilaksinë në praktikën stomatologjike. Rishikimi u fokusua në shkaktarët potencialë, manifestimet klinike, diagnozën diferenciale, vlerësimin urgjent sipas qasjes ABCDE, administrimin intramuskular të adrenalinës, mbështetjen e rrugëve të frymëmarrjes dhe oksigjenimin, pozicionimin e pacientit, monitorimin, pajisjet e emergjencës dhe përgatitjen e stafit. U morën në konsideratë rekomandimet përkatëse të organizatave ndërkombëtare të njohura të alergologjisë dhe reanimacionit.

Rezultatet. Dëshmitë e shqyrtuara tregojnë se anafilaksia mund të zhvillohet me shpejtësi dhe të përparojë në obstruksion të rëndë të rrugëve të frymëmarrjes, insuficiencë respiratore, hipotension, kolaps kardiovaskular dhe arrest kardiak. Manifestimet klinike mund të përfshijnë vështirësi të papritur në frymëmarrje, fishkëllimë, stridor, edemë të fytyrës ose rrugëve të frymëmarrjes, hipotension, takikardi, urtikarie të gjeneralizuar, skuqje të lëkurës, simptoma gastrointestinale dhe përkeqësim progresiv kardiovaskular. Kur dyshohet për anafilaksi, trajtimi duhet të fillojë menjëherë, pa pritur konfirmimin laboratorik. Adrenalina intramuskulare, e administruar në pjesën anterolaterale të kofshës sipas moshës dhe peshës së pacientit, është trajtimi i linjës së parë. Masat shtesë përfshijnë aktivizimin e shërbimeve të urgjencës mjekësore, pozicionimin e përshtatshëm të pacientit, mbështetjen e rrugëve të frymëmarrjes dhe oksigjenimin, monitorimin e vazhdueshëm të parametrave vitalë dhe përsëritjen e adrenalinës kur është klinikisht e indikuar. Disponueshmëria e adrenalinës, oksigjenit, pajisjeve për menaxhimin e rrugëve të frymëmarrjes, pajisjeve monitoruese, barnave të urgjencës dhe personelit të trajnuar është thelbësore për një përgjigje efektive.

Përfundimi. Njohja e hershme dhe administrimi i menjëhershëm intramuskular i adrenalinës janë komponentë themelorë të menaxhimit të suksesshëm të anafilaksisë në praktikën stomatologjike. Profesionistët e stomatologjisë duhet

të jenë të përgatitur për të njohur shenjat klinike të anafilaksisë dhe për të filluar trajtimin urgjent pa vonesë. Protokollet e standardizuara të emergjencës, pajisjet e përshtatshme, trajnimi i rregullt përmes simulimeve dhe komunikimi efektiv në ekip mund të përmirësojnë përgatitjen e ambulancës dentare dhe sigurinë e pacientit.

Fjalë kyçe: anafilaksi; praktikë stomatologjike; adrenalinë; menaxhim urgjent; anestetikë lokalë; urgjenca dentare; menaxhimi i rrugëve të frymëmarrjes.

MANAGEMENT OF ANAPHYLAXIS IN DENTAL PRACTICE: FROM SYMPTOM RECOGNITION TO EPINEPHRINE ADMINISTRATION

[1]Ilirian Lenjani [1]Besa Maloku [1]Fatime Lenjani

[1]Main Family Medicine Center - Dental Polyclinic

[3]Alma Mater Europaea *College Of Medical Sciences "REZONANCA"* Kosovo

Introduction. Anaphylaxis is a rare but potentially life-threatening systemic hypersensitivity reaction that may occur during dental treatment. Rapid recognition of clinical manifestations and immediate intervention are essential to prevent respiratory and cardiovascular deterioration. Potential triggers in dental practice include antibiotics, chlorhexidine, latex, local anesthetics, analgesics, and other substances used during dental procedures.

Aim. The aim of this review was to summarize the recognition and immediate management of anaphylaxis in the dental setting, with particular emphasis on early clinical assessment, prompt intramuscular epinephrine administration, emergency preparedness, and prevention of adverse outcomes.

Methodology. A narrative literature review was conducted using relevant scientific literature and current clinical recommendations concerning anaphylaxis in dental practice. The review focused on potential triggers, clinical manifestations, differential diagnosis, emergency assessment using the ABCDE approach, intramuscular epinephrine administration, airway and oxygen support, patient positioning, monitoring, emergency equipment, and staff preparedness. Relevant recommendations from recognized international allergy and resuscitation organizations were considered.

Results. The reviewed evidence indicates that anaphylaxis may develop rapidly and progress to severe airway obstruction, respiratory failure, hypotension, cardiovascular collapse, and cardiac arrest. Clinical manifestations may include sudden respiratory difficulty, wheezing, stridor, facial or airway edema, hypotension, tachycardia, generalized urticaria, flushing, gastrointestinal symptoms, and progressive cardiovascular deterioration. When anaphylaxis is suspected, treatment should begin immediately without waiting for laboratory confirmation. Intramuscular epinephrine administered into the anterolateral thigh according to age and weight is the first-line treatment. Additional measures include activation of emergency medical services, appropriate patient positioning, airway and oxygen support, continuous monitoring

of vital signs, and repeat epinephrine administration when clinically indicated. Adequate availability of epinephrine, oxygen, airway equipment, monitoring devices, emergency medications, and trained personnel is essential for effective response.

Conclusion. Early recognition and prompt intramuscular administration of epinephrine are fundamental components of successful anaphylaxis management in dental practice. Dental professionals should be prepared to recognize the clinical features of anaphylaxis and initiate emergency treatment without delay. Standardized emergency protocols, appropriate equipment, regular simulation-based training, and effective team communication may strengthen dental office preparedness and improve patient safety.

Keywords: anaphylaxis; dental practice; epinephrine; emergency management; local anesthetics; dental emergencies; airway management.

LIMB LENGTHENING: COMPARING THREE DIAGNOSTIC TOOLS

N. Atanasov, I. Veliu

University Clinic for Orthopaedic Surgery, Medical Faculty, University "Ss. Cyril and Methodius"- Skopje, Republic of Macedonia

This case study presents a detailed evaluation of bone regeneration during limb lengthening procedures using the Ilizarov technique. The study compares the effectiveness of three diagnostic methods—native radiography, ultrasonography, and osteodensitometry—in detecting bone changes during different stages of distraction osteogenesis. Fifty patients with 79 lengthened bones treated at the University Clinic for Orthopaedic Surgery in Skopje between 2020 and 2025 were evaluated. The study demonstrates that combined use of imaging and densitometric methods improves assessment of bone formation, enhances clinical decision-making, and contributes to safer timing for external fixator removal.

Introduction: Limb lengthening using the Ilizarov method is a well-established orthopedic procedure applied in the management of congenital deformities, post-traumatic shortening, infection-related bone loss, and other skeletal abnormalities. Successful treatment depends on controlled distraction osteogenesis and careful monitoring of new bone formation throughout the distraction and consolidation phases.Accurate assessment of regenerate bone quality is essential to avoid complications such as delayed union, nonunion, fractures, or premature frame removal. Traditionally, plain radiography has been the most commonly used method for evaluating regenerate bone. However, newer modalities such as ultrasonography and osteodensitometry provide additional insight into biological activity and mineralization.The purpose of this case study is to provide a detailed analysis of bone regeneration during limb lengthening by comparing the diagnostic value of native radiography, ultrasonography, and osteodensitometry.

Case Presentation: This study included 50 patients who underwent limb lengthening using the Ilizarov external fixation method between 2020 and 2025. A total of 79 bones

were analyzed. Patients were treated for different causes of limb shortening including congenital deformities, post-traumatic shortening, and growth disturbances. The Ilizarov technique involved corticotomy followed by gradual distraction at a standard rate of approximately 1 mm per day. Patients were monitored clinically and radiologically during distraction and consolidation phases.The evaluation of bone formation focused on three stages:1. Early Distraction Stage2. Active Bone Formation Stage3. Consolidation StageDuring each phase, the regenerate bone was evaluated using:- Native radiography- Ultrasonography- Osteodensitometry

DiagnosticMethods: 1. Native RadiographyPlain radiographs were obtained regularly to assess callus formation, cortical continuity, density, and alignment. Radiography allowed visualization of regenerate structure and identification of complications such as cystic changes or delayed consolidation.2. UltrasonographyUltrasound examination was performed to evaluate early vascular and soft tissue changes before radiographic visibility of bone formation. Ultrasonography was particularly useful in detecting early regenerate tissue organization and cystic formations.3. Osteodensitometry Bone mineral density measurements were used to evaluate the mineralization process of regenerate bone. Osteodensitometry demonstrated high sensitivity in identifying mineralization crises and delayed maturation during consolidation.

Statistical Analysis: The significance of differences between diagnostic methods was analyzed using Cochran's Q test and McNemar test. Statistical comparisons were performed to determine the reliability and sensitivity of each method at different stages of bone regeneration.

Results: The study demonstrated significant differences among the three diagnostic methods at various stages of distraction osteogenesis.Radiography provided reliable structural information during later stages but showed limitations in detecting early biologic changes. Ultrasonography demonstrated superior sensitivity in the early detection of regenerate tissue and cystic formations during distraction. Osteodensitometry proved highly sensitive in identifying mineralization deficiencies during consolidation.In the first stage, no statistically significant differences were identified between the methods regarding detection of cystic formations. However, during later stages, osteodensitometry identified mineralization crises that were not sufficiently visible on standard radiographs.The combined use of all three methods provided the most comprehensive evaluation of regenerate bone quality.

Discussion: Distraction osteogenesis is a dynamic biological process involving mechanical and biological factors. Monitoring this process is essential to optimize treatment outcomes and minimize complications.Radiography remains the standard diagnostic method due to its availability and ability to visualize bone structure. However, radiographs may underestimate early biologic activity. Ultrasonography supplements this limitation by providing earlier visualization of soft tissue organization and early regenerate development.Osteodensitometry contributes important information regarding mineral content and maturation of newly formed bone. Detection of mineralization crises is clinically important because insufficient mineralization may increase the risk of regenerate fracture after frame removal. The findings of this study support a multimodal diagnostic approach in patients undergoing limb lengthening procedures. Combining imaging modalities improves treatment planning, assists in adjustment of distraction dynamics, and enhances

timing for safe external fixator removal.

Clinical Significance: The clinical implications of this study are significant for orthopedic surgeons managing distraction osteogenesis. Early identification of inadequate bone formation allows timely intervention such as modification of distraction rate, optimization of nutrition, physiotherapy, or pharmacologic support.A combined diagnostic protocol may reduce complications, shorten treatment duration, and improve functional outcomes in patients treated with the Ilizarov method.

Conclusion: The comparative evaluation of radiography, ultrasonography, and osteodensitometry demonstrates that each diagnostic method provides unique and complementary information during limb lengthening.Radiography remains essential for structural assessment, ultrasonography improves early biologic evaluation, and osteodensitometry offers superior sensitivity in detecting mineralization changes during consolidation.The integration of these methods provides a more complete understanding of bone regeneration and contributes to improved clinical decision-making regarding distraction dynamics and timing of frame removal.

Keywords: Limb lengthening, Ilizarov method, distraction osteogenesis, radiography, ultrasonography, osteodensitometry, bone regeneration, orthopedic surgery.

RIFORMULIMI I STRATEGJISË KIRURGJIKALE: RIPARIM URGJENT ME TEKNIKËN FROZEN ELEPHANT TRUNK PAS ZGJATJES RETROGRADE TË DISEKSIONIT AKUT TË AORTËS TIP B – NJË GARË KUNDËR KOHËS

K. Xhelili, A. Selmani, E. Rushiti

IPSH Klinika Univerzitare për Kardiologji dhe Kirurgji Kardiovaskulare, Qendra Kombëtare Për Sëmundje Kardiovaskulare, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Hyrje: Diseksioni akut i aortës tip B është një sëmundje dinamike, ku progresioni anatomik mund t'a ndryshojë strategjinë optimale të tretmanit (1). Megjithëse rastet e pakomplikuara menaxhohen me terapi optimale medikamentoze, monitorimi i afërt është thelbësor për të identifikuar progresione që kërkokojnë ndërhyrje (1). Zgjatja retrograde e flepit drejt harkut përfaqëson një evolucion që rezulton në diseksion akut jo-A jo-B (2). Teknika Frozen Elephant Trunk (FET) mundëson njëkohësisht trajtimin e harkut dhe aortës descendente proksimale, lehtëson përjashtimin e çarjes hyrëse, zgjerimin e lumenit të vërtetë dhe remodelimin e favorshëm të aortës (3; 4). Ne paraqesim rastin e një diseksioni akut tip B që progredoi në diseksion akut jo-A jo-B dhe riparimin urgjent me teknikën FET.

Prezantimi i rastit: Një pacient 72-vjeçar paraqitet me dhimbje akute, shqyese në gjoks dhe shpinë. TK angiografike fillimisht konfirmoi diseksion akut të aortës Stanford tip B. Pacienti u pranua në njësinë e kujdesit intensiv. Pavarësisht analgjezisë adekuate dhe kontrollit të presionit arterial, dhimbja perzistoi gjatë dy ditëve në

vijim. TK angiografike kontrolluese tregoi zgjatje retrograde të flepit drejt harkut aortik me përfshirje të arteries subklavie të majtë. Për shkak të përkeqësimit klinik, progresionit radiologjik dhe anatomisë së papërshtatshme për trajtim endovaskular, u krye riparim urgjent me FET dhe revaskularizim të arteries subklavie të majtë, duke trajtuar njëkohësisht patologjinë e harkut dhe të aortës descendente. Ecuria postoperative ishte pa komplikime. TK angiografike postoperative nuk tregoi progresion të mëtejshëm të sëmundjes.

Konkluzioni: Diseksioni akut i aortës kërkon rivlerësim të vazhdueshëm dhe përshtatje të strategjive terapeutike (1). Zgjatja retrograde e diseksionit tip B përfaqëson një ndryshim kritik. Riparimi urgjent me FET ofron një zgjidhje efektive për pacientë të përzgjedhur, duke trajtuar njëkohësisht patologjinë komplekse të harkut dhe aortës descendente proksimale (3; 4).

NGA HIPERPLAZIA ENDOMETRIALE NË KARCINOMË ENDOMETRIALE TË KORPUSIT TË MITRËS: RAPORT RASTI

M. Skenderi-Shei, A. Dauti

Spitali i Përgjithshëm, Strugë

Hyrje: Hiperplazia endometriale përfaqëson një proliferim jonormal të gjëndrave endometriale dhe është një nga shkaqet e rëndësishme të gjakderdhjes vaginale anormale, veçanërisht në periudhën peri dhe postmenopauzale. Disa forma të hiperplazisë endometriale, veçanërisht ato të shoqëruara me atipi, konsiderohen lezione pararendëse të karcinomës endometriale. Vlerësimi klinik, gjinekologjik dhe konfirmimi histopatologjik kanë rol thelbësor në diagnostikimin e hershëm dhe përcaktimin e mëtejshëm të trajtimit.

Raport rasti: Paraqitet rasti i një pacienteje 62-vjeçare nga Struga, e cila u paraqit me dhimbje abdominale dhe gjakderdhje vaginale të zgjatur. Pas kryerjes së ekzaminimit gjinekologjik dhe vlerësimit laboratorik, duke marrë në konsideratë moshën e pacientes dhe simptomat klinike, u vendos për kryerjen e kiretazhit endometrial të fraksionuar (CEF). Materiali i marrë u dërgua për ekzaminim histopatologjik.

Ekzaminimi mikroskopik i materialit të kiretazhit evidentoi fragmente të shumta të indit neoplazik me origjinë nga epiteli endometrial. Qelizat neoplazike ishin të organizuara në struktura gjëndrrore të çrregullta, me zona kribriforme dhe karakteristika citologjike të malignitetit. U evidentuan struktura pseudostratifikuese me bërthama vezikulare hiperhromatike, pleomorfizëm qelizor dhe figura mitotike patologjike. Në një pjesë të materialit u evidentuan gjithashtu ndryshime në përputhje me hiperplazinë komplekse gjëndrrore me atipi, si dhe zona me diferencim papilar dhe eozinofilik.

Në materialin e ekzaminuar u identifikuan edhe fragmente të mukozës endocervikale, në stromën e së cilës evidentohej substrat neoplazik. Bazuar në karakteristikat morfologjike, gjetjet histopatologjike ishin në përputhje me karcinomë endometriale të korpusit të mitrës, FIGO gradë II, me përfshirje të mukozës cervikale.

Përfundime: Gjakderdhja vaginale e zgjatur në pacientet postmenopauzale kërkon

një vlerësim të plotë klinik, gjinekologjik dhe histopatologjik. Kiretazhi endometrial përfaqëson një metodë të rëndësishme diagnostike në identifikimin e patologjive endometriale. Ky rast evidenton rëndësinë e ekzaminimit histopatologjik të materialit të marrë gjatë CEF, pasi një paraqitje klinike e dyshuar për hiperplazi endometriale mund të shoqërohet me ndryshime malinje të endometrit. Diagnostikimi i hershëm i karcinomës endometriale është i rëndësishëm për përcaktimin e mëtejshëm të trajtimit dhe menaxhimit të pacientes.

Fjalë kyçe: Hiperplazi endometriale, karcinomë endometriale, endometër, gjakderdhje vaginale, kiretazh endometrial, CEF, FIGO gradë II.

CONSERVATIVE MANAGEMENT OF AN INCIDENTAL NEONATAL ARACHNOID CYST: A CASE REPORT

M. Gjorgjioska, A. Bogoevska, S. Ristovska, M. Dichoska, O. Stomnaroska, V. Livrinova

University Clinic of Gynecology and Obstetrics, Skopje, RN Macedonia

Introduction: Arachnoid cysts are cerebrospinal fluid-filled lesions of uncertain etiology, occasionally associated with other congenital malformations. Although the natural history of arachnoid cysts is not extensively documented in the literature, they are typically discovered incidentally during prenatal screening or during evaluation for macrocephaly, developmental delay, or seizures.

Case presentation: A female term neonate, with a birth weight of 3370 g, was delivered at 39+6 gestational weeks via Cesarean section due to fetal distress. Prenatal ultrasonography had revealed a suspected porencephalic lesion. The infant was born vigorous, with Apgar scores permitting routine adaptation and no requirement for primary resuscitation. Initial transfontanelle cranial ultrasound demonstrated a large cystic lesion in the right periventricular region. Following a neurosurgical consultation, head MRI was performed, revealing a large arachnoid cyst within the right hemisphere, with maximum dimensions measured 65x41 mm, causing local compression of the adjacent brain parenchyma of the right hemisphere and no communication with the ventricular system. Throughout the NICU stay, the infant remained consistently stable, with no neurological symptoms. Post-discharge follow-up revealed normal growth and neurodevelopment, with no indication for surgical intervention and continued clinical monitoring.

Conclusion: This case demonstrates that large congenital arachnoid cysts in neonates can remain completely asymptomatic and may be safely managed conservatively with close clinical and neuroimaging follow-up.

Keywords: arachnoid cyst, neonate, conservative management

СПЕКТАР НА БАКТЕРИСКИ УРОПАТОГЕНИ И АНТИМИКРОБНА РЕЗИСТЕНЦИЈА СО ПОСЕБЕН ОСВРТ НА *ESCHERICHIA COLI* – ИСКУСТВО НА ЦЈЗ СКОПЈЕ

M. Osman[1], M. Aleksovski[1], M. Selmani[3], A.T. Ristovska[2], S. Xholeka[1], E. Shaqiri[1], N. Islami[1], B. Mehmeti[1]

[1] Центар за јавно здравје-Скопје

[2] Биотек

[3] Центар за јавно здравје -Тетово

Вовед: Инфекциите на уринарниот тракт (ИУТ) се меѓу најчестите бактериски инфекции, при што *Escherichia coli* претставува доминантен уропатоген. Зголемената антимикробна резистенција, особено кај ESBL-продуцирачките Enterobacterales, претставува значаен предизвик во третманот на ИУТ.

Цел: Целта на студијата беше да се утврди спектарот на бактериски уропатогени изолирани од примероци на урина и нивниот профил на антимикробна резистенција, со посебен осврт на *E. coli* и ESBL-позитивните *E. coli* изолати.

Материјали и методи: Анализирани беа вкупно 380 бактериски изолати од примероци на урина. Идентификацијата беше извршена со MALDI-TOF MS технологија на VITEK® MS PRIME, а испитувањето на антимикробната осетливост со VITEK® 2 Compact. Advanced Expert System™ (AES) беше користен за експертска интерпретација и валидација на резултатите од испитувањето на антимикробната осетливост.

Резултати: *E. coli* беше најзастапен уропатоген со 308 (81,1%) изолати, следен од *Klebsiella spp.* со 39 (10,3%), *Citrobacter spp.* со 10 (2,6%), *Enterobacter cloacae/ complex* со 9 (2,4%) и други Gram-негативни бактерии со 14 (3,7%) изолати. Од *E. coli* изолатите со достапен ESBL резултат, 59/306 (19,3%) беа ESBL-позитивни. Највисока резистенција кај *E. coli* беше забележана кон ampicillin (64,7%), ciprofloxacin (47,7%), levofloxacin (46,4%) и trimethoprim/sulfamethoxazole (37,6%). ESBL-позитивните *E. coli* покажаа особено висока резистенција кон цефалоспориниte од трета генерација и флуорокинолоните.

Заклучок: *E. coli* беше доминантен уропатоген, со значителна застапеност на ESBL-позитивни изолати и висока резистенција кон повеќе често применувани антимикробни лекови. MALDI-TOF MS овозможува брза идентификација на уропатогените и го насочува изборот на соодветното последователно AST тестирање, додека VITEK 2 Compact со AES овозможува стандардизирано испитување и експертска интерпретација на антимикробната осетливост. Континуираното следење на локалните профили на антимикробна резистенција е од значење за соодветно справување со ИУТ.

Клучни зборови: *Escherichia coli*, инфекции на уринарниот тракт, антимикробна резистенција, ESBL, MALDI-TOF MS.

HIPERTENSIONI TE TË RINJTË: FAKTORËT E RREZIKUT, SHKAQET DYTËSORE DHE RREZIKU KARDIOVASKULAR AFATGJATË

M. Limani, A. Dalipi

ISHP Poliklinika Neomedika, Kumanovë, Maqedonia e Veriut

Hyrje: Hipertensioni arterial në moshë të re mund të mbetet i pazbuluar për një kohë të gjatë. Megjithëse rreziku absolut kardiovaskular është përgjithësisht më i ulët se te të moshuarit, presioni arterial i rritur në këtë periudhë lidhet me rrezik më të lartë për ngjarje kardiovaskulare në jetën e mëvonshme.

Qëllimi: Të shqyrtohen faktorët që lidhen me hipertensionin te të rinjtë, rëndësia klinike e shkaqeve dytësore dhe lidhja midis presionit të rritur në moshë të re dhe rrezikut të mëvonshëm kardiovaskular.

Metodologjia: Rishikim narrativ i literaturës shkencore, duke u mbështetur në kërkime në PubMed dhe në shqyrtimin e burimeve bibliografike përkatëse, me fokus te rishikimet sistematike, meta-analizat, studimet kohortë dhe udhëzimet klinike, duke u përqendruar në faktorët e modifikueshëm të rrezikut, hipertensionin dytësor dhe pasojat kardiovaskulare afatgjata.

Rezultatet: Hipertensioni në moshë të re lidhet me mbipeshën dhe obezitetin, marrjen e lartë të natriumit, çrregullimet metabolike dhe faktorët socialë e të sjelljes Mungesa e simptomave mund të kontribuojë në diagnostikimin e vonuar, ndërsa matjet jashtë ordinancës mund të ndihmojnë në identifikimin e hipertensionit të maskuar. Në një studim me 2 090 pacientë hipertensivë të moshës 18–40 vjeç, të vlerësuar në qendra të specializuara në Francë, shkaqe dytësore u identifikuan në 29,6% të rasteve. Një meta-analizë e 17 studimeve kohortë me rreth 4,5 milionë të rritur të rinj, evidentoi lidhje graduale midis presionit të rritur dhe ngjarjeve kardiovaskulare gjatë ndjekjes afatgjatë, ndërsa rreziku absolut ndryshon sipas profilit individual.

Përfundimi: Hipertensioni te të rinjtë meriton më shumë vëmendje klinike për shkak të diagnostikimit të vonuar dhe ekspozimit të zgjatur. Përmirësimi i zbulimit të hershëm kërkon matje të standardizuara të presionit arterial, konfirmim diagnostik kur indikohet dhe vlerësim të individualizuar për shkaqe dytësore, krahas ndërhyrjeve mbi faktorët e modifikueshëm të rrezikut.

Fjalët kyçe: hipertension arterial, të rinj, hipertension dytësor, rrezik kardiovaskular, faktorë rreziku, kujdes primar

KARDIOPATITË E LINDURA TEK FËMIJËT – NGA SHENJAT E PARA KLINIKE DERI TE DIAGNOZA EKOKARDIOGRAFIKE

M. Xhaferi, B. Vejseli

Klinika Univerzitare për Sëmundje të fëmijëve Shkup

Hyrje: Kardiopatitë e lindura përfaqësojnë anomalitë strukturore më të shpeshta të pranishme që në lindje dhe karakterizohen nga një spektër i gjerë klinik, nga defekte të vogla hemodinamikisht të parëndësishme deri te kardiopatitë kritike që kërkojnë diagnostikim dhe trajtim urgjent në periudhën neonatale. Njohja e hershme e tyre mbetet një nga sfidat e rëndësishme në praktikën pediatrike.

Qëllimi: Të paraqitet një qasje praktike dhe sistematike për njohjen e hershme të kardiopative të lindura tek fëmijët, duke lidhur shenjat dhe simptomat klinike me gjetjet ekokardiografike dhe rëndësinë hemodinamike të defektit.

Përmbajtja: Manifestimet klinike varen nga mosha, anatomia e defektit dhe ndryshimet hemodinamike. Tek neonati, cianoza, hipoksemia, takipnea, perfuzioni i dobët, pulset femorale të dobëta ose mungesa e tyre dhe shenjat e shokut mund të jenë tregues të një kardiopatie kritike. Tek foshnjat dhe fëmijët më të mëdhenj, vështirësitë në ushqyerje, mosrritja adekuate në peshë, intoleranca ndaj aktivitetit dhe zhurma kardiake mund të jenë shenjat e para të sëmundjes. Ekzaminimi klinik sistematik, pulsoksimetria dhe vlerësimi i pulseve periferike janë elemente të rëndësishme të diagnostikimit fillestar. Ekokardiografia me Doppler mbetet metoda kryesore për përcaktimin e anatomisë kardiake, drejtimit të shunteve, gradientëve dhe rëndësisë hemodinamike të lezionit.

Përfundim: Diagnostikimi i hershëm i kardiopative të lindura kërkon kombinimin e vlerësimit të kujdesshëm klinik me metodat bashkëkohore diagnostike. Jo çdo zhurmë kardiake nënkupton kardiopati, ndërsa mungesa e zhurmës nuk përjashton një kardiopati serioze. Njohja në kohë e shenjave alarmuese dhe përdorimi i orientuar i ekokardiografisë mundësojnë referim dhe trajtim në kohën e duhur, duke përmirësuar prognozën e fëmijëve me kardiopati të lindura.

Fjalë kyçe: kardiopati të lindura, zhurmë kardiake, ekokardiografi, Doppler.

INCIDENTAL DETECTION OF AN INFRARENAL ABDOMINAL ANEURYSM DURING ROUTINE TRANSTHORACIC ECHOCARDIOGRAPHY: A CASE REPORT

M. Nuredini[1,2], S. Nesimi[3], L. Asani[2], A. Sinani[3], S. Arsllani[1,3], S. Idrizi[3]

[1] Faculty of Medical Sciences, University of Tetova – Tetovo, North Macedonia
[2] Department of Cardiology, Clinical Hospital Tetovo
[3] Department of Internal Medicine, Clinical Hospital Tetovo

Abdominal aortic aneurysm (AAA) is often clinically silent and may remain undiagnosed until advanced disease or acute complications occur. Although transthoracic echocardiography (TTE) is primarily performed for cardiac assessment, visualization of the abdominal aorta may occasionally reveal previously unrecognized vascular abnormalities.

We present a 63-year-old man who underwent routine cardiology evaluation without abdominal or chest pain and with no previous awareness of vascular disease. He was a current smoker and reported back pain that he had attributed to his physically demanding agricultural work. During transthoracic echocardiography, the abdominal aorta was visualized as part of the routine examination, revealing abnormal aortic dilatation. Subsequent computed tomography angiography confirmed an infrarenal abdominal aortic aneurysm extending from the level of the renal arteries to the aortic bifurcation, with involvement of the proximal iliac arteries and pronounced peripheral mural thrombus. The maximum aneurysm diameter was 49 × 46 mm, while the patent lumen measured up to 35 mm. The patient was subsequently referred for vascular surgical evaluation and further management.

